



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • ëëë.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 82

Prishtinë, Dt. 09/01/2026

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT
TE DIPLOMES MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Gjeografi/Gjeografi
Projekt-propozimi	Ndikimi i turizmit në ndryshimin e shfrytëzimit të sipërfaqeve të tokës në Parkun Kombëtar "Sharri", rast studimi: Brezovica dhe Prevala (The impact of tourism in changing the use of National Park "Sharri" land: A case study in Brezovica and Prevala)
Kandidati	Visar BRAHIMI
Mentori	Prof. Asst. Dr. Fitim HUMOLLI
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 26.12.2023 Vendimi nr.:7915; Vendimi për shtyrje: 289,dt.30.01.2025

Pas punës fillestare, konsultative të kandidatit me udhëheqësin shkencor për temën master dhe vazhdimin të studimeve në terren të kandidatit, si dhe bazuar në kërkesën e kandidatit Visar Brahim i të datës 26.12.2025 me nr. 5104, paraqesim këtë raport.

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT

Tema me titull "Ndikimi i turizmit në ndryshimin e shfrytëzimit të sipërfaqeve të tokës në Parkun Kombëtar "Sharri", rast studimi: Brezovica dhe Prevala" i kandidatit Visar Brahim i përbën studim të veçantë gjeografik që inkorporon fusha studimi nga ato tekniko gjeografike në ato turistiko gjeografike. Duke i vlerësuar si të pamjaftueshme studimet e kësaj natyre edhe në Kosovë por në veçanti në rastet e studimit tonë, kandidati së bashku me mentorin zgjodhën këtë çështje dhe temë për trajtim. Me këtë, ata synuan mbulimin e hendikepit mbi

studime të tilla si dhe nevojat praktike për të gjeturat nga ky rast në dy zona brenda Parkut Kombëtar Sharri. E tillë, në format dhe në shtrirje, si dhe me një metodologji bashkëkohore, tema vërtet merr kuptimin e një trajtесе tërësisht të munguar dhe mjaftë të nevojshme.

Tema trajton problematika studimore mjaft specifike dhe për këtë, mentori i temës së bashku me kandidatin kanë përzgjedhur metodologjinë e duhur, bazuar kryesisht në produkte të metodës së GIS-it si një mundësi teknologjike e cila siguron të dhëna të besueshme për arritjen e rezultateve.

Të vetëdijshëm se ka edhe modele tjera metodologjike edhe më të shpejta për arritjen e rezultateve, ne zgjodhëm vegla klasike të GIS pikërisht duke pretenduar kulaitet saktësor mbi kuantitetin dhe qëndrueshmëri të dhënash në raport me shpejtësinë.

Kjo duket mirë e menduar dhe mirë e trajtuar kur vlerësohen rezultatet e dorëzuara, si draft nga ana e kandidatit.

Rezultatet e studimit mund të përfaqësojnë me besueshmëri, drejtimet kryesore të lëvizjeve të destinimit të tokave në rastet Prevall dhe Brezovicë. Ato, kësisoj tregojnë për një tendencë të shfaqur në drejtimin e ndryshimit të destinimit, kryesisht nga kategoritë e pyjeve dhe kullosave në destinime turistike. Ndër to në toka për shfrytëzim komercialo turistike, si: hotele, motele, shtëpi banimi turistike, ambiente tjera përcjellëse të shtëpive, infrastrukturë shoqëruese etj. Në studim është evidentuar se sipërfaqja e zonave të banimit në Brezovicë është zgjeruar nga 30.65 ha në 74.70 ha, ndërsa në Prevallë nga 4.44 ha në 15.77 ha.

Duke hedhur pyetjet hulumtuese, të definuar qartë me qëllimin e studimit, objektivat e këtij punimi, gjithashtu të parashtruara në projekt propozim, u arritën dhe tanimë rezultatet dëshmuuan këtë.

Rezultatet e studimit ofrojnë një bazë të fortë për zhvillimin e politikave turistike, në dhe rreth zonave të mbrojtura e në veçanti Parqeve Kombëtare. Duke u bazuar në to, vendimmarrësit kanë mundësi më ta mira për të parë se si po ndryshojnë dhe nga çfarë faktorësh ndikohen zonat e tilla. Për këto arsye, një nismë e tillë studimore, tërësisht joshteruese është e pëlqyer dhe kurajuese për vijimin e studimeve tjera.

Kandidati i ka qëndruar besnik formatit të punimit, sipas rregullores aktuale të studimeve master. Dorëshkrimi ka pasqyruar metodologji adekuate për natyrën e studimit, ndërsa materialet vektoriale, imazhet, hartat, grafikët dhe tabelat, vetëm sa e kanë plotësuar punimin e studimit në fjalë.

PROPOZIM

Punimi i Diplomës më titull **“Ndikimi i turizmit në ndryshimin e shfrytëzimit të sipërfaqeve të tokës në Parkun Kombëtar "Sharri", rast studimi: Brezovica dhe Prevala”** i kandidatit Visar Brahimi, paraqet një kontribut të çmuar në studimet gjeografike në përgjithësi dhe atyre të GIS në funksion të zonave turistike si pjesë e studimeve gjeografiko-turistike, në veçanti. Mbështetur në vlerësimin e punimit të kandidatit, një pjesë e të cilave janë shënuar sipëri, komisioni profesional/shkencor vlerëson se punimi i plotëson të gjitha kushtet formale, juridike dhe profesionale-shkencore për mbrojtje publike.

Prishtinë: 08.01.2026

Komisioni:

1. _____

Prof. Dr. Florim Isufi - Kryetar

2. _____

Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli – anëtar (mentor)

3. _____

Prof. Assoc. Dr. Shpejtim Bulliqi - anëtar